

KONVENTA PËR INTEGRIMIN EUROPIAN

Grupi i Punës III

(Siguria Ushqimore, Veterinaria, Mbrojtja e Bimëve, Bujqësia dhe Zhvillimi Rural – Kapitujt 11 dhe 12)

Sesioni 2, Tema: “Sfidat në adoptimin dhe zbatimin e standardeve të sigurisë dhe cilësisë ushqimore nga AKU dhe operatorët e biznesit ushqimor”

6 tetor 2015, 10:00 – 12:00

Hotel Tirana

Zhvillimet aktuale

Më datë 6 Tetor, u organizua Sesioni i II i Grupit të Punës së Bujqësisë, gjatë së cilit u diskutua mbi sfidat në adoptimin dhe zbatimin e standardeve të sigurisë dhe cilësisë ushqimore nga AKU dhe operatorët e biznesit ushqimor. Takimi u përqendrua në nevojën e zbatimit të funksioneve për garantimin e funksionimit të sistemit të sigurisë ushqimore nga Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, si dhe pengesat që sjellin në zbatimin e këtyre funksioneve ndarja e tyre në disa institucione publike duke e bërë të paqartë përgjegjësinë ndaj këtyre funksioneve dhe duke sjellë konfuzion në operatorët e biznesit ushqimor.

Grupi i Punës i Bujqësisë gjatë Sesionit të II nënvizoi se Autoriteti kompetent AKU duhet kurdoherë të kryejë funksionet e tij bazuar në tre parime të rëndësishme:

1. *Analizë e riskut* – Në sajë të funksionimit të Komitetit Shkencor dhe paneleve shkencore, nga ana strukturore analiza e riskut është e realizueshme në vendin tonë.
2. *Vlerësimi mbi bazën e riskut* -Nëpërmjet vlerësimit mbi bazën e riskut jepen dhe alokohen burimet njerëzore.
3. *Menaxhimi i riskut* është funksioni kryesor që duhet të ketë AKU, por ndarja apo copëzimi institucional që ekziston në Shqipëri e bën të vështirë funksionimin e këtij parimi.

U konsiderua si arritje dyfishimi i operatorëve ushqimor që gjatë vitit 2014 kanë adoptuar sistemin HACCP, i projektuar dhe zbatuar sipas kërkesave themelore të sigurisë ushqimore. Nëpërmjet HACCP si risi prezantohet dhe metodologjia që përcakton kriteret për nivelin e riskut, dhe një plan veprimi që siguron zbatimin e metodologjisë. Sistemi i menaxhimit të sigurisë ushqimore bazuar në HACCP vendos masa mbrojtëse për të eliminuar ose reduktuar rreziqet e mundshme gjatë prodhimit, ruajtjes dhe shpërndarjes.

Problematika & Rekomandime

Grupi i Punës ngiti si domosdoshmëri **reformimin e sistemit ushqimor dhe atij veterinar**, që do të forcojë kontrollin ushqimor. Reforma e sipërpërmendur do të sillte shpërndarje më të mirë edhe të burimeve njerëzore të cilat janë të shpërndara në qeverisjen qendrore dhe atë lokale pa një strukturë të unifikuar. Një strukturë e unifikuar e burimeve njerëzore do të ndihmonte në mirëfunksionimin e zinxhirit të sigurisë ushqimore.

Një tjetër çështje që vazhdon të përbëjë problem është edhe mbivendosja e kompetencave ndërmjet institucioneve të ndryshme. AKU zotëron përgjegjësinë më të madhe në kontrollin ushqimor, por nuk ka mekanizmat pasi kontrolli i është lënë pushtetit lokal. Në këtë rast nuk ka konflikt ligjor, por problemi qëndron te struktura e cila duhet rregulluar e modifikuar ligjërisht.

Grupi i Punës III përmendi si problematike **mungesën e infrastrukturës** për të realizuar inspektimet si psh. mungesa frigoriferësh në kufij apo nevoja për aparate në laboratore për kontrollin zyrtar. Si zgjidhje e problemit u sugjerua forcimi i një partneriteti publik-privat.

Si element lidhës mes operatorëve të biznesit dhe AKU është **gjurmueshmëria**, faktori kyç i kontrollit dhe identitetit të prejardhjes së produktit. Për garantimin e sigurisë ushqimore duhet të ekzistojë jo vetëm bashkëpunimi i institucioneve me njëri – tjetrin, por edhe **ndërveprimi mes institucioneve shtetërore dhe operatorëve të biznesit**. Eksperti sllovak i Grupit të Punës solli disa sugjerime si:

- Organizimi në klube i operatorëve të biznesit, sipas fushave të tyre dhe përfshirja në grupet e punës për hartime legjislacioni
- Në kuadër të legjislacionit të BE-së të organizohen **trajnime të përbashkëta** mes operatorëve dhe inspektorëve gjë që ndihmon në kuptueshmërinë e punës, me problemet dhe të përbashkëtat e njëri-tjetrit në arritjet e qëllimeve.
- Marrëveshje të arritura mes Ministrisë së Bujqësisë, Ministrisë së Shëndetit, institucioneve tatimore dhe doganore për Plane Pune dhe kontrole të përbashkëta, duke ulur kostot dhe afatet kohore.

Në rastin e Shqipërisë është e domosdoshme që nën AKU disa shërbime të intensifikohen. Për funksionimin e thertoreve të autorizuara, duhet të përgatiten aktet nënligjore. Sipas Grupit të Punës kjo do të mundësonte një konkurrencë të drejtë.

Në raste **konflikt interesi të kontrolleve** në nivel lokal, duhet të dërgohen inspektorë nga drejtori qendrore, të cilët nuk njoftohen për subjektin që do të kontrollohet.

Grupi i Punës rekomandoi realizimin e **një Auditi të brendshëm**, audit vertikal nga zyra qendrore në zyrat lokale, që mund të bëhet 1 herë në 5 vjet.



Pjesëmarrës në Sesionin I, Grupin e Punës: Institucione shtetërore dhe shoqëri civile

Institucione shtetërore :

Afrim Bakaj- Drejtor i Përgjithshëm i AKU(Autoriteti Kombëtar i Ushqimit)

Lulëzime Shalari- Inspektor, Drejtoria e Përgjithshme AKU

Zana Cifligu- Ekspert Mjedisor AKU

Sefer Sefa- Ekspert Mjedisi i licensuar për VNM, AKU

Nerta Çeço- Jurist, AKU

Amneris Drenofci- Zyra e Shtypit, AKU

Angjelina Vuksani, Sektori i Mbrojtjes së Bimëve, AKU

Ilir Ajdini- Inspektor, AKU

Arsonela Mio, Gentiana Bardhi, Aurora Buci, Eriselda Gega, Anisa Hoxha - AKU

Shoqëri Civile:

Florian Xhafa -Ekspert i Grupit të Punës EMA

Ymer Tola- Drejtor Ekzekutiv, KASH(Këshilli i Agrobiznesit Shqiptar)

Ago Nezha-KASH

Bashkim Maçi-KASH

Gentian Cane- Unioni Shqiptar Kursim Kredi

Merita Uruçi- ADAMA(Shoqata shqiptare e bulmetit dhe mishit)

Sabah Sena- Risi Albania

Bjolanda Cuku- Gazetare TVSH

